

VENDIM
Nr.557, datë 11.8.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.881, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR FUNKSIONET DREJTUESE
DHE PËR STRUKTURËN E NIVELET E PAGAVE NË MINISTRINË E PUNËVE TË
JASHTME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” të nenit 18 të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 45 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.881, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr.1, që përmendet në pikën 1, të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pika 1/1 ndryshon, si më poshtë vijon:

“1/1. Paga e grupit (kolona 2) e lidhjes nr.1, është sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

c) Pika 1/2 shfuqizohet.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2011, të përballohen nga fondet e politikës së pagave të planifikuara për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha